

VENDIM
Nr.349, datë 27.3.2008

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHES (KP) TË ANËTARËVE TË RINJ TË
AKADEMISË SË SHKENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.9853, datë 26.12.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9655, datë 12.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e komisionit përzgjedhës të anëtarëve të rinj të Akademisë së Shkencave, me këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------------------|----------|
| a) Prof. dr. Gudar Beqiraj | kryetar; |
| b) Prof. dr. Dhimitër Haxhimihali | anëtar; |
| c) Prof. dr. Farudin Hoxha | anëtar; |
| ç) Prof. dr. Jani Thomai | anëtar; |
| d) Prof. dr. Francesko Altimari | anëtar; |
| dh) Prof dr Azedine Beschaouch | anëtar; |
| e) Prof. dr. Franz Hofmann | anëtar; |
| e) Prof. dr. Walter Hoflechner | anëtar; |
| f) Prof. dr. Sandro De Maria | anëtar. |

2. Akademisë së Shkencave, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, t’i shtohet fondi prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të udhëtimit e të qëndrimit të shkencëtarëve të huaj, anëtarë të komisionit përzgjedhës.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha